REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3698/4 prot. Pogradec, më 21.09.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
"Për MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 8,5543 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA."

Me respekt,

K R Y E T A R I
Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)
Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)
Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 8 (Tete)

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ prot. Pogradec, më ____. ___2026

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË____/____/2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 8,5543 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" , neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e siperfaqes së tokës bujqësore prej **8,5543** Ha (Tete hektar dhe 5543 metra katror) të ndodhur në Njësinë Administrative Çërravë, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësia	Z K	Nr Pasurisë	Vol	Faqe	Vëndodhja	Sip m2	Lloji
1	Shtet	2420	73	11	54	Leshnicë, Çërravë	73666	Arë
2	Shtet	2420	82	11	53	Leshnicë, Çërravë	11877	Arë
						TOTALI	**85543**	

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj.
3. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
4. Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
5. Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Bordi qeradhenies tokes bujqesore , si dhe Njësia Administrative Çërravë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr.3647/4 Prot. Pogradec, më 21.09.2026

Relacion

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 8,5543 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" , neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe ne zbatim te urdherit nr 733 prot datë 21/09/2020 të Kryetarit të Bashkisë të vënë në zbatim me Memo me nr prot 3579 datë 03/08/2021, ligjit 57/220 "Per pyjet", VKM nr 559 date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" sektori i verifikimit te titujve te pronesise dhe shpronesimeve ne bashkepunim me Njesine administrative Çërravë ka evidentuar dhe listuar nje numër pasurish që mund të jepen me qera të sipërfaqes prej **8,5543 Ha** të ndodhur në Njësinë Administrative Çërravë. Në referim të Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" , Bashkia Pogradec para se të kerkojë në Këshillin Bashkiak miratimin e listës ka kryer verifikimin e faktit se keto sipërfaqe kane zërin kadastral tokë bujqësore Are, dhe se kjo pasuri preken nga persona private apo ka pretendime.

Gjithashtu theksojmë se kjo pasuri **nuk është pjesë e vendimit** të **Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 9.12.2015 Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim komunave Buçimas, Çërravë dhe Udënisht dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 8.6.2011.**

Gjithashtu **kjo parcele nuk eshte pjesë e Vendimit Nr. 770**, datë 12.11.2014 për kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim të njësive të qeverisjes vendore, vendim që në Bashkinë Pogradec prek një sipërfaqe prej **1990,64 ha përkatesisht Njesia Administrative Velçan 391,35 Ha, Njësia Administrative Buçimas 238,11 Ha, Njesia Administrative Çërravë 50,09 Ha , Njësia Administrative Trebinjë 282,66 Ha, Njësia Administrative Dardhas 516,13 Ha, Njesia Administrative Proptisht 445,45 Ha dhe Njësia Administrative Udenisht 66,85Ha**,

Gjithashtu kjo sipërfaqe toke **i kanë kaluar në perdorim** ish Komunes Çërravë, me Vendimin nr.417 datë 08.06.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Çërravë, të qarkut të Korçës".

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Gjithashtu theksojmë faktin se në zbatim të V.K.M-së nr. 510, datë 10.6.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" të gjitha të drejtat e pronësisë që iu takonin ish- Komunave tani i takojnë Bashkisë Pogradec.

Në këto kushte dhe bazuar në nënin 54 gërma "e" të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr.3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë listën dhe sipërfaqet përkatëse të parcelave që mund të jepen me qera , të ndodhur në Njësinë Administrative Buçimas, sipas tabelës dhe sasisë totale te pasqyruar ne projektvendim

Në referim të bazës ligjore nga Drejtoria e emergjencave, strehimit dhe administrimit tokes bujqesore ne njesite administrative, Sektori trajtimit titujve pronesise dhe shpronesimeve, u krijohen korrespodencat dhe dokumuntacioni përkatës me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Angjesine Shteterore te Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec dhe Njësinë Administrative për të zbatuar sa më mirë dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave për dhënien me qera të këtyre sipërfaqeve dhe zbatimin edhe te urdherave qe ka nxjerre Kryetari i Bashkise per zbatimin sa me te mire dhe transparent te ketij Udhezimi, duke pergatitur shkresat dhe modelet e akteve te verifikimit dhe njoftimet qe njesite administrative kane administruar dhe do marrin nga ana jone per te bere proçesin sa me transparent per publikin dhe palet e interesuara.

Ne date 16 Qershor 2026 ora 12.oo ne fshatin Leshnice u organizua konsultimi publik me komunitetin me pjesemarrjen e perfaqesuesve te Keshillit Bashkiak, Bashkise, Njesise Administrative dhe kryesise se Fshatit dhe nuk pati kontestime apo kundershtime dhe asnje banor skishte pretendime pronesie.

Duke qene se jane kaluar te gjitha hapat e nevojshme ligjore kerkojme miratimin tuaj per vazhdimin e procedurave ligjore.

Ju faleminderit!

Konceptoi Kristjan MENKSHI

Miratoi: Nexhmi TORRA

Konfirmoi Dritan BABASULI

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

PËRFITUESI I SË DREJTËS *(qiramarrës, enfiteozmarrës, kreditorhipotekor, etj)*	
Emri(emër, atësidhembiemër)/emriipersonitjuridik	**Nr. Personal ID/NIPT**
BASHKIA POGRADEC	**K44802605R**

Numri i pasurisë	**73**		
Kodi unik i pasurisë	**2420011054**		
Zona Kadastrale	**2420**		
Lloji i pasurisë	**ARE**		
Sipërfaqja e pasurisë	**73666 m²**		
Sipërfaqja, ose pjesa takuese e pasurisë, që është objekt i të drejtës reale	**73666 m²**		
Akti i Perfituesit	**VKM NR. 417, DATE 08/06/2011, NE PERDORIM BASHKIA POGRADEC**		
Afati i të drejtës	**-**		
Adresa e pasurisë	**Pogradec**		
Pronari/ Bashkëpronarët *(qeradhënës, enfiteozdhënës, etj)*	**Emër, atësi, mbiemër ose emri i personitj uridik**	**Nr. Personal ID/NIPT**	**Pjesa (-/-)**
SHTET			**1/1**

DREJTORI
ZHULJEN MANELLARI

Data e Lëshimit 29.09.2025
REF. 01341

Denis Muci — Digitally signed by: Denis Muci, Date: 2025.09.29 10:04:51 +02'00'
Eugen Alinj — Digitally signed by: Eugen Alinj, Date: 2025.09.29 10:41:08 +02'00'
Zhuljen Manellari — Digitally signed by: Zhuljen Manellari, Date: 2025.09.30 03:41:46 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Pogradec
Date:2025/09/29 10:05:30 +02'00'
K44802605R2025092910052384014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Pogradec)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: _2420 KODI UNIK: 2420.....

NUMRI PASURISË :73 IND.HARTES:K-34-114-104-C

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:5000

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Pogradec
Date:2025/09/29 10:40:26 +02'00'
K44802605R20250929104019790l4

Zhuljen Manellari

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Pogradec)

SHPJEGUES
- PARCELA
- NDERTESA

HARTOGRAF

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2420011054
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2420 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 73 , Sipërfaqja Totale 73666 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-114-(103-D), (104-C), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia Cerrave , Rruga Fshati Leshnice , Ndërtesa Nr. ____ , SH/K ____ ,
Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 01341 , Dt. 29/09/2025), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET - - , Nr. Identifikimi/NIPT K111111111L , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia . , Rruga . , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: . Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi , Nr. 01341 , Datë: 29/09/2025
Regjistruar: Nr. 01341 , Datë: 29/09/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
01341	29/09/2025	Përdorim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	VKM 417	08/06/2011	99 vite	BASHKIA POGRADEC	K44802605R

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: Sipas urdherit te ASHK POGRADEC u ndryshua nr i volum,faqes, urdheri nr 782 dt 26.09.2025 -URDHER PER AFISHIM 45 DITOR NR. 1619 PROT, DATE 17/04/2025

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Denis Muci — Digitally signed by: Denis Muci, Date: 2025.09.29 10:04:16 +02'00'

Eugen Alinj — Digitally signed by: Eugen Alinj, Date: 2025.09.29 10:40:35 +02'00'

Zhuljen Manellari — Digitally signed by: Zhuljen Manellari, Date: 2025.09.30 03:38:05 +02'00'

Data e lëshimit 29/09/2025

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Pogradec
Date:2025/09/29 10:04:40 +02'00'
K44802605R20250929100432 76ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 16/06/2026 Ora : 12 / :00 Vendi: Fshati Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 12 banorë

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

"PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 8,5543 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPET ME QIRA"

Pjesëmarrës :

Mimoza Shuli (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Alketa Beka (Këshilltare)

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Nexhmi Torra (Drejtor I Emergjencave)

Gerond Oshafi (Specialist)

Suela Mertkola (Punonjëse Sekretarjati)

Znj. Shuli: Përshëndetje, ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Më bëhet qejfi që tokat kërkohen nga vetë banorët e zonës. Ne jemi këtu për t'ju mbështetur. Të jeni të bindur se çdo projektvendim që vjen në Këshill vjen pas konsultimit dhe miratimit të banorëve, ndaj pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme. Fjalën ia jap Z. Gjona.

Z. Gjona: Jo detyrimisht merret konfirmimi në Këshill.

Znj. Shuli: Pikërisht për këtë arsye zhvillohet konsultimi publik.

Z. Torra: Përshëndetje. Atëherë, të sqarojmë pozicionin dhe pronën për të cilën bëhet fjalë. Bëhet fjalë për dy prona, pasuritë nr. 78 dhe 82. Për pjesën ballore, nga verifikimi që kemi kryer në zyrën e Regjistrimit, të dyja këto parcela rezultojnë pronë shtetërore. Nuk ka shënime në kartela apo dokumentacion tjetër. Kemi kërkuar informacion edhe pranë zyrës së AMTP-së dhe përgjigjja ka qenë negative. Në këto kushte kemi nisur procedurat për dhënien me qira. Sipërfaqja është rreth 8.5 hektarë.

Znj. Beka: Aktualisht e shfrytëzon ndonjë person?

Z. Torra: Jo, aktualisht nuk i shfrytëzon askush, janë të lira.

Znj. Beka: Kush ka shprehur interes, banorët apo persona të tjerë?

Z. Torra: Po, vetë banorët.

Banor: Do të pyeten edhe banorët. Shumica mund të jetë dakord, por mund të ketë edhe ndonjë banor që ka kundërshtime. Nuk mund të konsiderohet ligj vetëm mendimi I I dy banorëve.

Z. Gjona: Këto parcela ndodhen ngjitur me ato të Cerravës?

Z. Torra: Jo, nuk janë ngjitur. Ato ndahen nga dy pasuri të tjera. Çdokush ka të drejtë të shprehë mendimin e tij. Konsultimi publik bëhet pikërisht për këtë arsye. Nëse kjo prone është objekt i ndonjë vendimi gjykate ose i përket dikujt, ne duhet të jemi në dijeni.

Znj. Olldashi: Ju lutem, përpara se të japë mendimin e tij, secili të prezantohet.

Z. Alban: Edhe fushat duhen punuar, pasi janë lënë të gjitha pa u shfrytëzuar.

Z. Pengu: Ne kemi bërë një investim shumë të madh, sipas të gjitha parametrave. Vetëm sistemi vaditës ka kushtuar mbi 250 mijë euro.

Z. Gjona: Ju jeni pronar i kantinës?

Z. Pengu: Jo, unë kam malin me gështenja. Deri tani çdo gjë është bërë shumë mirë dhe të gjitha investimet i kam kryer vetë. Shuma e investuar ka qenë shumë e madhe.

Z. Gjona: Nuk jeni financuar nga askush?

Z. Pengu: Jo, çdo gjë e kam bërë vetë. Kam marrë vetëm një kredi, ndërsa pjesën tjetër e kam përballuar me mundësitë e mia.

Znj. Olldashi: Pra, ju jeni subjekti që ka shprehur interes?

Z. Pengu: Po, ne jemi të interesuarit. Jemi djem të fshatit dhe këtu janë edhe përfaqësuesit e tjerë. Kemi marrë opinionin e shumicës së banorëve të fshatit. Ata e dinë situatën dhe secili mund të flasë vetë.

Z. Lipo: Ne duam të bëjmë një investim tjetër në atë zonë.

Z. Torra: Investimin do ta paraqisni kur të hapet procedura, përmes dokumentacionit përkatës që do të dorëzoni së bashku me kërkesën.

Z. Pengu: Ne e kemi treguar se çfarë dimë të bëjmë. Kemi punësuar edhe shumë persona nga fshati ynë.

Z. Torra: Diçka që duhet ta sqaroj dhe të jem i saktë: nëse aty ka rrugë ekzistuese, ato duhet të mirëmbahen dhe jo të prishen. Nuk dua të kemi probleme të tilla apo ankesa nga banorët. Ju lutem, ta merrni në konsideratë që tani.

Z. Pengu: E kemi shumë të qartë dhe ju keni të drejtë. Kudo ku kemi vendosur rrethime, kemi ndërtuar edhe rrugë të reja. Rrugët janë të hapura për të gjithë. Madje pretendoj që pas dy vitesh, nëse projekti realizohet, do të lejohet edhe kullotja e bagëtive të fshatit. Nuk do të ndalohet bagëtia, sepse kjo i shërben si komunitetit ashtu edhe neve.

Z. Gjona: Ajo që arrij të kuptoj është se ky është një rast i veçantë dhe një konsultim publik ku duket se shumica e banorëve janë dakord.

Z. Pengu: Unë jam djalë fshati dhe kam punësuar shumë njerëz. Do të bëj çdo gjë për fshatin tim. Pyesni kë të doni, ne jemi një fshat model.

Z. Daci: Unë jam marrë me emigracionin, por asnjëherë nuk e kam lënë fshatin. Kur pashë fshatin dhe punën që kanë bërë këta djem, shkova vetë në terren dhe nuk kam çfarë të them. Kur shikon që ajo kodër vaditet me një sistem unik dhe, për më tepër, nuk do të ndalohet as blegtoria, atëherë çdo gjë është në të mirë të zonës. Çdo investim ka vlerë. Nëse vazhdojnë me këtë ritëm, është në të mirë të tyre dhe të gjithë zonës.

Z. Hamzallari: Nuk ka asnjë dobi që tokat të qëndrojnë pa u shfrytëzuar. Le t'i marrin dhe t'I punojnë.

Z. Pengu: Unë vetë kam bërë të gjitha kanalet dhe rrugët e Cerravës, sepse aty kalojnë njerëzit. Çdo rrugë që kam ndërtuar e kam bërë për fshatin tim.

Z. Lipo: Çdo gjë e kemi bërë me shpenzimet tona. Sot autokombajna kalon në çdo vend.

Z. Gjona: Ajo që dua të ngre përsëri është...

Znj. Olldashi: T'i japim fillimisht fjalën agronomit dhe më pas ju lutem vazhdoni.

Z. Gjona: E njëjta frymë u pa edhe gjatë konsultimit që u zhvillua në Cerravë. Në atë konsultim të gjithë ishin dakord, por më pas u krijua një zhurmë e madhe. Megjithatë, unë mendoj se këtu është e përfaqësuar vetëm një pjesë e fshatit.

Administratori: Personat që ndodhen këtu janë përfaqësues të lagjeve.

Z. Begu: Këtu është bërë një investim dhe ata kanë ardhur për të zgjeruar aktivitetin edhe në pjesën tjetër.

Znj. Beka: Ne kemi ardhur këtu për çështjen e dhënies së tokave me qira dhe për të evidentuar nëse ka pretendime pronësie.

Z. Lipo: Mendimin e Klejdit do ta plotësoj unë. Ai ka të drejtë të shprehë shqetësimin e tij, sepse nesër mund të ketë probleme. Unë kam komunikuar nëpër lagje dhe të gjithë janë dakord. Tani jemi në fazën e finalizimit të pyetësorit.

Z. Gjona: Nuk janë lajmëruar të gjithë.

Z. Lipo: Unë i kam lajmëruar.

Banor: Bëhet fjalë për prodhim bujqësor dhe për ne nuk përbën problem.

Administratori: Nuk ka kundërshtime.

Z. Pengu: Në tokën e parë që mora kisha mundësinë të bëja një investim tjetër, por nuk e bëra, sepse nuk dua që në zonën që rrethon Leshnicën të ketë ndërtime të tjera. Qëllimi është të mbillen pyje dhe kullota, në mënyrë që gjithçka të jetë në favor të zonës.

Z. Gjona: Më fal, por ti je njëra palë. Këshilli zakonisht dëgjon edhe palën tjetër.

Kryeplaku: Unë kam folur me banorët dhe çdo gjë është në rregull.

Znj. Shuli: Ne kemi ardhur për të zhvilluar një takim me banorët dhe për t'u ardhur në ndihmë.

Kryeplaku: Ne na intereson që këto toka të prodhojnë, të gjelbërohen dhe të krijojnë më shumë oksigjen. Na intereson që të punohet dhe nuk kemi asnjë kundërshtim.

Znj. Shuli: Ne na intereson që banorët të marrin në përdorim tokat që ende janë të pashfrytëzuara.

Z. Gjona: Unë nuk jam kundër zhvillimit, thjesht nuk dua të krijohen probleme.

Znj. Shuli: Nëse nuk ka diçka tjetër për të diskutuar, ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Protokolloi : Suela Mertkola

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO